



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARREDHENIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE PËR EFEKT REGJISTRIMI.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 25 e 42 të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, neneve (7, pika 2.b) 11,13,14 e 15, të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar si dhe nenet 192 dhe 193 të Kodit Civil i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Brendshëm,

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për vendosjen nën një regjim të rregullt juridik të procedurës së ndjekur nga ana e njësive të qeverisjes vendore për kalimin e pronësisë së trojeve të dhëna për ndërtim si dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme.
2. Rregullat e përcaktuara në këtë vendim do të zbatohen për trojet e dhëna për ndërtim dhe të tjetërsuara nga Bashkitë, ish Komunat dhe ish Këshillat e Rretheve pas datës 10/08/1991 deri në hyrjen në fuqi të VKM nr. 24/2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 270, datë 22.4.2010

3. Institucioni i ngarkuar nga Këshilli i Ministrave për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi trojet e dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore është Bashkia ku gjendet pasuria e paluajtshme.

## II. PROCEDURA E TRAJTIMIT TË KALIMEVE TE PRONËSISË TË TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA BASHKIA, ISH KOMUNA DHE KËSHILLAVE TË RRETHEVE TË REGJISTRUARA NË REGJISTRAT E PASURIVE TË PALUAJTSHME.

Kur trualli i dhënë për ndërtim nga Bashkia dhe ish Komunat, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, figuron e regjistruar në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, veprohet, si më poshtë vijon:

1. Kur trualli nuk figuron në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve si pasojë e transaksionit të realizuar me të tretë, ose e shpronësimit, të kryer për interes publik, me përjashtim të kalimit të pronësisë nëpërmjet akteve të trashëgimisë, e reflektuar kjo në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të tretët nuk ndalohen të kryejnë veprime, me përjashtim të rastit kur kjo pasuri krijon mbivendosje me një pasuri tjetër të paluajtshme, e cila nuk rrjedh nga e njëjta origjinë;
2. Kur trualli figuron ende në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, apo ish Komunat ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer, sipas rasteve të mëposhtme:

### - Rasti A

Trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore pa akt noterial (vetëm mandate pagese) përpara hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994 dhe kjo pasuri është regjistruar së bashku me ndërtesën e përfituar me leje ndërtimit të miratuar konform ligjeve të urbanistikës të kohës.

Nëse akti i kalimit të pronësisë së truallit të lidhur me Bashkinë dhe ish Komunën është lidhur përpara datës 01/11/1994, që i përket hyrjes në fuqi të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, zyra vendore e regjistrimit të pasurisë vijon me realizimin e kërkesës për pajisje me dokument pronësie, pas konfirmimit të dosjes përkatëse nga Bashkia.

Kërkesa për konfirmim i paraqitet Bashkisë brenda 2 ditëve nga konstatimi. Bashkia brenda 15 ditëve përcjell dokumentacionin e kërkuar pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

... procedura një afat prej 3 muajsh, subjekti përfitues i drejtohet për konfirmimin e titullit të pronësisë.

#### - Rasti B

Trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore pa akt noterial (vetëm mandate pagese) pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994 dhe kjo pasuri është regjistruar së bashku me ndërtesën e përfituar me leje ndërtimit të miratuar konform ligjeve të urbanistikës të kohës.

Nëse akti i kalimit të pronësisë së truallit të lidhur me Bashkinë dhe ish Komunën është lidhur pas datës 01/11/1994, që i përket hyrjes në fuqi të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe nuk është në formën e kërkuar nga ligji, zyra vendore e regjistrimit të pasurisë njofton brenda 2 ditëve nga konstatimi Bashkinë, duke vënë në dijeni këtë të fundit për gjendjen juridike të pasurisë.

Bashkia pas njoftimit nga ana e zyrës vendore të regjistrimit të paluajtshme, nis menjëherë verifikimin nëse për truallin përkatës;

- administrohet Vendim i Këshillit Bashkiak, Vendimi i ish Këshillit të Rrethit, apo Vendim i Këshillit Komunal
- është paguar vlera e plotë, apo e pjesshme e blerjes së truallit (mbi 50%), duke arkëtuar vlerën e papaguar sipas çmimit të caktuar në aktin e kalimit të pronësisë, ku 30% e shumës i kalon Bashkisë dhe 70% i kalon ATP- së për fondin e kompensimit të ish pronarëve.

Pas verifikimeve të mësipërme Bashkia vijon me lidhjen e aktit noterial me subjektin përkatës dhe brenda 15 ditëve dërgon për regjistrim aktin e mësipërm së bashku me planvendosjen përkatëse.

Nëse procedura e mësipërme nuk kryhet nga Bashkia brenda një afati prej 3 muaj subjekti kërkues i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e çështjes.

#### Rasti C

Trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore pa akt noterial (vetëm mandate pagese) pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994 dhe mbi të është ndërtuar një ndërtesë në proces legalizimi

Në rastin kur mbi truallin e përfituar me një akt që nuk është në formën e kërkuar nga ligji, është ndërtuar një ndërtesë në proces legalizimi, procedura e rregullimit të marrëdhënieve me truallin do të kryhet nga Agjencia përkatëse përgjegjëse për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave informale.

Trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore me akt noterial dhe mbi të është ndërtuar dhe regjistruar konform ligjeve të kohës edhe ndërtesa.

Nëse mbi truallin e dhënë për ndërtim është ngritur dhe regjistruar ndërtimi konform ligjeve të urbaniztikës, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme vijon me realizimin e shërbimit të kërkuar, për pajisje me çertifikatë, të aplikuar pranë saj sipas nenit 71 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme." të ndryshuar

Rasti E

Trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore me akt noterial dhe mbi të nuk është ndërtuar dhe regjistruar konform ligjeve të kohës asnjë ndërtesë.

Nëse mbi truallin e dhënë për ndërtim nuk është ngritur dhe regjistruar asnjë ndërtim konform ligjeve të urbaniztikës, dhe ky truall nuk krijon mbivendosje me pasuri të tjera të regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 2 ditëve nga konstatimi kërkon konfirmimin dhe përcjelljen e aktit dhe dosjen përkatëse përkatës të pronësisë nga Bashkia,

Pas konfirmimit të mësipërm, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme vijon me lëshimin e dokumentit të pronësisë, me shënimin në seksisonin "E" të kartelës së pasurisë, që trualli është dhënë për ndërtim.

Nëse Bashkia nuk kryhen konfirmimin e kërkuar brenda një afati prej 3 muaj, subjekti kërkues i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e pretendimeve të pronësisë.

### III. PROCEDURA E TRAJTIMIT TË KALIMEVE TE PRONËSISË TË TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA BASHKIA ISH KOMUNA DHE ISH KËSHILLAVE TË RRETHEVE TË PA REGJISTRUARA NË REGJISTRAT E PASURIVE TË PALUAJTSHME.

Kur trualli i dhënë për ndërtim nga Bashkia dhe ish Komunat, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk figuron i regjistruar në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas rastit veprohet, si më poshtë vijon:

Rasti A.

Trualli për ndërtim, nuk figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve Bashkia, por për të disponohet

pasurive të pasurive të paluajtshme.

Në rastet ku Bashkia administron Vendimin e Këshillit Bashkiak, kontratën noteriale, pagesën e e blerjes së truallit, planimetrinë e sheshit të ndërtimit, dhe jo domosdoshmërisht procesverbalin e piketimit, ky institucion përcjellë për regjistrim në ZVRPP dokumentacionin e mësipërm duke konfirmuar njëkohësisht nëse mbi këtë truall është realizuar, apo jo ndërtim.

Bashkia përpara kryerjes së procedurës së mësipërme konfirmon pranë ZVRPP gjendjen juridike të pasurisë truall.

Në rastet kur nga ana e Bashkisë konfirmohet dhe dërgohet për regjistrim vetëm dokumentacioni i truallit dhe mbi këtë truall nuk është ngritur asnjë ndërtim, ZVRPP vijon me kryerjen e regjistrimit përkatës me shënimin në seksionin "E", që trualli është dhënë për ndërtim.

Në rast se mbi truallin e mësipërm rezulton të jetë ndërtuar dhe regjistruar ndërtim, ZVRPP vijon me regjistrimin përkatës të kërkuar dhe lëshimin e certifikatë së pronësisë.

Nëse konfirmimi i mësipërm nuk kryhet nga Bashkia brenda një afati prej 3 muaj, ZVRPP refuzon me urdhër të arsyetuar kërkesën për regjistrim dhe subjekti kërkuar I drejtohet gjykatës.

#### Rasti B

Trualli për ndërtim, nuk figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve Bashkia, për të nuk disponohet akt noterial kalimi pronësie, por vetëm mandate pagese (që vërtetojnë pagesën e pjeshme, apo të plotë të truallit) si dhe vendimi i Këshillit Bashkiak që ka miratuar tjetërsimin. Mbi këtë truall është ngritur dhe regjistruar një ndërtim konform ligjeve përkatëse të urbanistikës.

Kur pasuria, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk figuron e regjistruar në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve Bashkia ngarkohet të kryejë procedurën paraprake të përgatitjes së dokumentacionit të kalimit të pronësisë si dhe përcjelljen e tyre për regjistrim në ZVRPP në kushtet e përcaktuara si më poshtë;

Në rastet ku Bashkia administron Vendimin e Këshillit Bashkiak, kontratën jo noteriale, pagesën e plotë, apo të pjeshme të blerjes së truallit (mbi 50%), planimetrinë e sheshit të ndërtimit, dhe jo domosdoshmërisht procesverbalin e piketimit, ky institucion autorizohet për lidhjen e aktit noterial, duke arkëtuar fillimisht vlerën e mbetur të çmimit të caktuar në aktin e kalimit të pronësisë, ku 30% e shumës që do të arkëtohet i kalon Bashkisë dhe 70 % kalon ATP-së për fondin e kompensimit të ish pronarëve.

...në bashki, apo përfundimtare të inventarit të pronave në administrim/pronësi të saj.

Akti noterial së bashku me dosjen përkatëse përcillen për regjistrim në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Bashkitë përcjellin dokumentacionin për regjistrim pranë ZVRPP brenda 15 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës së qytetarit.

Nëse procedura e mësipërme nuk kryhet nga Bashkia brenda 3 muajve, subjekti kërkues I drejtohet gjykatës.

Kalimi i pronësisë i trojeve, për të cilat Bashkia nuk disponon Vendim Këshilli Bashkiak, mandate pagesa përkatëse me të cilat vërtetohet shlyeja e plotë apo e pjesshme (mbi 50 %) e vlerës së truallit, kryhet sipas procedurës së parashikuar në Ligjin nr. 10 270, datë 22.4.2010 "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij" të ndryshuar.

- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi ZVRPP, ngarkohen për heqjen e kufizimit të veprimeve mbi trojet e përfituara për ndërtim nga Bashkitë, ish Këshillat e Rretheve dhe ish Komunat, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë akt nënligjor.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Bashkitë, ZVRPP-të dhe Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

# RELACION

## PËR

### PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE PËR EFEKT REGJISTRIMI”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim të bëjë një rregullim ligjor, lidhur me procedurat e tjetërsimit të trojeve për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore, duke përcaktuar një sërë rregullash të bashkërendimit të punës së bashkive me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje për efekt regjistrimi”

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave, dhe as me dokumente të tjera politike.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë veprimtarisë së përditshme të regjistrimit të pasurive të paluajtshme është vërejtur mungesë e akteve nënligjore lidhur me procedurat e tjetërsimit të trojeve për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore, që ka pasqyellë bllokimin e procesit të regjistrimit dhe kryerjes së veprimeve të mëtejshme juridike mbi këto pasuri, dhe për rrjedhojë pasoja në aspektin ekonomik, social dhe zhvillimor në përgjithësi.

... madje me numrin e rasteve të tjetërsimit të trojeve per ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi një pjesë e tyre nuk janë të regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajjtshme.

Në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajjtshme, fenomeni i tjetërsimit të trojeve për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit aktual të planifikimit urban, është vërejtur i përhapur kryesisht në Sarandë, Tiranë, Vlorë, Durrës, Korçë, etj. ku numri më i lartë i rasteve është vërejtur në qytetin e Sarandës.

Nga ana tjetër kontratat e mësipërme të kalimit të pronësisë të trojeve për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore, nuk janë shpallur të pavlefshme sipas nenit 92 të Kodit Civil dhe në disa raste kanë sjellë edhe pasoja juridike.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajjtshme në respektim të rekomandimeve të KLSH, përcaktimeve të nenit 195 të Kodit Civil dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajjtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit." duke qenë se, në kontrata e shitjes së lidhura ndërmjet njësitë të qeverisjes vendore dhe subjekteve privat, për shitjen e trojeve për ndërtim pala shitëse e pasurisë së paluajjtshme nuk rezulton të jetë e regjistruar në cilësinë e pronares së pasurisë në regjistrat përkatës që administron ZVRPP-ja, ka disponuar për refuzimin e kërkesave për regjistrim ose për kufizimin e veprimeve kur këto pasuri kanë qenë të regjistruara.

Ky qëndrim ka sjellë bllokimin e qarkullimit civil të pasurive të mësipërme duke sjellë pasoja në aspektin ekonomik, social dhe zhvillimor në përgjithësi.

ZRPP, e cila është përfshirë në procesin e mësipërm dhe gjithashtu është bërë në një mënyrë pengesë për ushtrimin e të drejtave pasurore dhe shfrytëzimin ekonomik të pronës, shpesh është përballur me fluksin e madh të ankesave të subjekteve të prekur, të cilët janë orientuar t'i drejtohen gjykatës.

Subjektet në këtë mënyrë janë gjendur përballë një situatë të paqartë, pasi nga një institucion shtetëror nuk u është lejuar ushtrimi i të drejtave të tyre pasurore të fituara në bazë të një titulli të lidhur me një institucion tjetër shtetëror që për lidhjen e kontratave të mësipërme është bazuar në nenin 7 të Ligjit 7693 dt. 06.04.1993 "Për Urbanistikën", nenin 43, 55 të Ligji nr. 8405 datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën" dhe nenin 32 të Ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000, "Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore". Madje baza ligjore për shitjen e këtyre trojeve ka qenë edhe



... Kushtetuese, e cila me Vendimin nr.2 datë 25.01.1999 nuk e ka konsideruar antikushtetues nenin 55 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", mbi bazën e të cilit janë bërë dhe shitjet e trojeve nga Bashkia.

Mungesa e një akti ligjor për rregullimin e situatës së mësipërme, ka lënë vend për interpretime të dispozitave në fuqi, gjë e cila nuk është në tagër të ZRPP-së. Për pasojë lind e nevojshme marrja e një nisme për rregullimin ligjor të situatës së krijuar nga mungesa e akteve nënligjore për rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë mbi trojet e shpërndara për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore.

#### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm.

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përbëhet nga tre krerë.

Gjatë veprimtarisë së zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë konstatuar rastet e mëposhtme të tjetërsimit të trojeve për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore, trajtimi i të cilave perfshihet në mënyrë të specifikuar në projektvendim kur:

- I. trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore pa akt noterial (vetëm mandate pagese) përpara hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vititi 1994 dhe kjo pasuri është regjistruar së bashku me ndërtesën e përfituar me leje ndërtimit të miratuar konform ligjeve të urbanistikës të kohës.
- II. trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore pa akt noterial (vetëm mandate pagese) pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vititi 1994 dhe kjo pasuri

miratuar konform ligjeve të urbanistikës të kohës.

- III. trualli për ndërtim i përfituar sipër pikave I dhe II nuk figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues por në emër të personave të tretë, apo shtetit si pasojë e transaksionit të realizuar me të tretë, ose shpronësimit, të kryer për interes publik,
- IV. trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore pa akt noterial (vetëm mandate pagese) pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994 dhe mbi të është ndërtuar nja ndërtesë në proces legalizimi.
- V. trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore me akt noterial dhe mbi të është ndërtuar dhe regjistruar konform ligjeve të kohës edhe ndërtesa.
- VI. trualli për ndërtim figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues të kësaj pasurie nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore me akt noterial dhe mbi të nuk është ndërtuar dhe regjistruar konform ligjeve të kohës asnjë ndërtesë.
- VII. trualli për ndërtim, nuk figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve Bashkia, por për të disponohet akt noterial kalimi pronësie, që është paraqitur dhe aplikuar për regjistrim pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Mbi këtë truall nuk konstatohet nga të dhënat kadastrale të jetë ngritur ndërtim.
- VIII. trualli për ndërtim, nuk figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve Bashkia, por për të disponohet akt noterial kalimi pronësie, që është paraqitur dhe aplikuar për regjistrim pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Mbi këtë truall konstatohet nga të dhënat kadastrale të jetë ngritur dhe regjistruar ndërtim konform ligjeve përkatëse të urbanistikës.
- IX. trualli për ndërtim, nuk figuron i regjistruar në pronësi të subjektit përfitues me truall për ndërtim nga Bashkia, ish Komunat, apo ish Këshillat e Rretheve Bashkia, për të nuk disponohet akt noterial kalimi pronësie, por vetëm mandate pagese (që vërtetojnë pagesën e pjesshme, apo të plotë të truallit) si dhe vendimi i Këshillit Bashkiak që ka miratuar tjetërsimin. Mbi këtë truall

Miratimi i aktit të mësipërm do të sillte zhbllokimin e procesit të regjistrimit dhe lejimin e qarkullimit civil të trojeve, të cilat janë përfituar në bazë të akteve të kalimit të pronësisë të lidhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe që nuk janë kundërshtuar në gjykatë.

### VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe përcillet si bashkëpropozim i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Brendshëm. Projektakti i dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-akte, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe në formë shkresore Agjencisë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

### VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ZVRPP-të, Bashkitë dhe Drejtoritë Rajonale të Aluiznit.

### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në projektvendim është propozuar që përballimi i efekteve financiare, të kryhet nga Bashkitë.

MINISTRI I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTRI I BRENDSHËM

Sandër Lleshaj